



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI FINANCËS**

Relacion “mbi Raportin e Monitorimit të Buxhetit për periudhën e 8-mujorit të vitit 2023”

Të nderuar,

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve, ka si qëllim kryesor të sigurojë zbatimin e legjislacionit të punës në subjektet fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj, privatë ose publik, që ushtrojnë veprimtari ekonomike fitimprurëse apo jo fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë.

Ky mision arrihet nëpërmjet kontrollit, konstatimit, këshillimit, njoftimit, formimit, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimit. Ky mision realizohet nëpërmjet procedurave të inspektimit në punë si dhe duke u bazuar në kuadrin ligjor përkatës. Inspektorati Shtetëror i Punës ngarkohet:

Të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjenën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;

T’u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore;

Të vërë në dijeni autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes. Në kuadër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit, por edhe të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, bazuar në Ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Në zbatim të Udhëzimit Nr.14, Datë 30.05.2023 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 19.01.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2023”, në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për 8-mujorin e vitit 2023, për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Në tabelën në vijim, po ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhënat mbi buxhetin e miratuar dhe realizimin e tyre sipas artikujve.

Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan Rishikuar Viti 2023	Fakti i i Periudhes /progresiv
Shpenzime Personeli	112.295.6	160.495	181.928	107.514
Shpenzime Korrente	28.094.0	27.127	27.127	16.391
Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	3.503.0	5.000.0	5.000.0	3.463
Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0,0	0,0	0,0	0,0
Trans per Buxhet Familjar dhe individ	2.638.8	48.0	0.348	0.313
Shpenzime te ardhura nga jashte limitit	1.175			
TOTALI	166.865	192.670.0	214,403	127,681

Në mënyrë analitike, performanca e objektivave dhe realizimit të shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2023 për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Raporti i shpenzimeve sipas programeve, për periudhën Janar-Gusht 2023, është si më poshtë:

Buxheti i miratuar për vitin 2023 është 214.403 mijë lekë.

Shpenzime Korrente

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 për zërin paga dhe sigurime është 181.928 mijë lekë. Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat dhe sigurimet e punonjësve të

ISHPSHSH-së. Në muajn Prill të vitit 2023 pagat e punonjësve mbështetës u rritën sipas VKM me Nr. 242 Datë 20.04.2023 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.234, DATË 20.04.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE

TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, TË NDRYSHUAR”. Me vendimin me Nr. 325, Datë 31.05.2023 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHITESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, u rriten pagat e punonjësve të institucionit. Fondi i pagave për 8-mujorin e vitit 2023 është realizuar në vlerën 107.514 mijë lekë të shprehur në përqindje është në masën 59% .

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera Operative.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 është 27.127 mijë lekë. Me këtë zë shpënzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si drita, ujë, telefon, elektricitet, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë, karburant, mirembajtje, etj. Në këtë artikull janë kryer shpenzime për dieta brenda vendit ku si pasojë e ndryshimit të strukturës dhe rritja e numrit të inspektorëve e bënë të nevojshëm përdorimin me efikasitet të këtij zëri në buxhetin e 2023, në funksion të veprimtarisë inspektuese. Gjatë 8-mujorit ky zëri buxhetor 602 është realizuar nga 27.127 mijë lekë në 16.391 mijë lekë të shprehur në përqindje 60%.

3- Transferta, Fond i Veçantë. Llogaria 606

Në zbatim të shkresës nr 2196/4 datë 21.02.2023, protokolluar me tonën nr 388 datë 24.02.2023 është dhënë Fond i Veçantë në vlerën 300 mijë lekë për daljen e punonjësve në pension, raste sëmundjeje. ku janë kryer pagesa për personelin e dalë në pension, sipas udhëzimit plotësues të MFE Nr. 2, Datë 19.01.2023”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”. Gjithashtu dhe fondi alokuar nga buxheti i shtetit për telefonin celular dhe dëmshpërblimet si rezultat i ndryshimit të strukturës së ISHPSHSH me vlerë 48,000 lekë . Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore për 8- mujorin e vitit 2023 realizoi këtë fond në vlerën 313.1 mijë lekë, në një përqindje 90%.

4- Shpenzime për Investime kapitale

Fondi i investimeve për vitin 2023 është 5000 lekë ku Inspektorati shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore fondin e alokuar të investimeve nga buxheti i shtetit e ka shpërndarë në zëra si më poshtë :

1. Blerje pajisje kompjuterike/elektronike me një vlerë prej 4500 lekë për plotësimin e nevojave të inspektorëve për ecurinë normale dhe funksionale të punës së tyre të përditëshme. Një procedurë kjo e cila realizohet nga Agjencia Kombëtare Shtetërore e Informacionit si organi kompetent për pajisjet elektronike/kompjuterike. Në këtë rast ISHPSHSH paraqet vetëm kërkesën pranë kësaj Agjencie duke u bazuar në specifikimet teknike dhe çmimet referuese të publikuara në faqen zyrtare të këtij institucioni. Për vitin 2023 ISHPSHSH ka realizuar procesimin e një detyrimi të prapambetur të këtij projekti nga viti 2022 në vlerën 44(dyzet e katër)lekë dhe ka realizuar në bashkëpunim me AKSHIN, procedurën për blerje pajisje kompjuterike mbi kërkesën e depozituar nga institucioni jonë pranë Agjencisë Kombëtare Shtetërore të Informacionit gjatë këtij 8 mujori, ku institucioni ka lidhur kontratë me operatorin ekonomik të shpallur fitues në vlerën 3419 lekë.

Mbas procedurës së realizuar nga AKSHI për këtë projekt institucionit i mbetën akoma fonde në dispozicion, dhe duke pasur akoma nevojë për pajisje kompjuterike për mbulimin e nevojave të

punës së përditëshme të inspektorëve dhe për një mirëmenaxhim të fondeve buxhetore, ka kërkuar miratimin nga AKSHI, pjesërisht për diferencën e pa realizuar të fondit si dhe konfirmimin e tij për pajisjet kompjuterike, specifikimet teknike të tyre, duke u bazuar edhe në çmimet referuese të publikuara në faqen zyrtare të këtij institucioni. Me shkresën Nr. 4138/1, Datë 15.08.2023, AKSHI ka dhënë miratimin për vazhdimin e procedurës e cila është në proces nga institucioni.

2. Rikonstruksioni i jashtëm (muri rrethues)Administrata Qëndrore e ISHP-së me një vlerë 500 lekë per kete zë është realizuar e gjithë procedura dhe ne kete periudhe institucioni eshte në proces likujdimi te kontrates se lidhur me operatorin ekonomik, brenda muajit Shtator ky projekt do realizohet afersisht në masën 100% të tij.

5- Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore për 8 mujorin e vitit 2023 nuk ka pas të ardhura jashtë limitit të buxhetit të shtetit.

6- Objektivat .Treguesit e performancës në nivel qëllimi/objektivi:

- Përmirësimi i procesit të inspektimit.

Përmirësimi i cilësise së inspektimit dhe mbulimi me inspektim i çeshtjeve specifike e konkrete të inspektimit të punës, (Informaliteti, siguria dhe shëndeti në punë etj), në lidhje me zbatimin nga subjektet e legjislacionit të punës që rregullon marrëdhëniet e punës, kushtet e punës dhe shendetin në punë të punëmarrësve. Ky tregues ka pësuar përmirësim të ndjeshëm gjatë këtij viti ku kemi orientuar, përmes përmirësimit të elementëve të riskut për programim të subjekteve, që kanë apo mbartin informalitet gri, i cili gjendet në elementë të caktuar të marrëdhënies së punës duke ndikuar drejtpërsëdrejti në cilësinë e një pune të denjë për punëmarrësit.

Në këtë kuadër ka rezultuar se:

Është zgjeruar harta e subjekteve që marin shërbimin e inspektimit për herë të parë në masën 22 % e inspektimeve të planifikuara gjatë vitit, ose 2 % më shumë se objektivi i parashikuar.

Target 20% e subjekteve të planit do të përbëhet nga subjekte të painspektuara më parë.

Reduktimi i informalitetit në të gjitha format e shfaqjes së tij, përmes orientimit të planifikimit të inspektimeve në subjekte me risk të lartë.

Target 60% e subjekteve të planit do të përzgjidhen me bazë risku. Gjatë periudhës së 8-mujorit janë realizuar 6355 inspektime ku deri në fund të vitit 2023 planifikohet të realizohen 10000 inspektime .

Objektivi i politikës së programit: “Promovimi i një kulture parandaluese për bërjen e vendeve të punës të sigurt të shëndetshëm e produktive :

- Zhvillim i fushatave të kontrollit dhe ndërgjegjësimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, të cilët janë identifikuar me risk në drejtim të informalitetit, sigurisë dhe shëndetit në punë

Jane realizuar dy fushata në Aktivitetin ndërtim dhe Hoteleri-Turizëm.

- Sektori Ndërtim ku trupa inspektuese ka kryer inspektime në këtë sektor ka realizuar 401 inspektime, verifikime, ku janë kontrolluar 3280 vende pune.
- Fushata në aktivitetin Tregti, Hotel-Bar-Restorante, për shkak të sezonit turistik ka vëmendje të punës inspektuese për sa i takon evidentimit të informalitetit gri, si turnet e punës, ditët e pushimeve javore, orët e punës mbi kohën normale, etj gjatë periudhës qershor-gusht janë kryer 1187 inspektime në këtë aktivitet, ku janë kontrolluar 14235 vende pune.
- Organizimi i të paktën 4 tryezave të rrumbullakëta me pjesmarrjen e përfaqësuesve të sindikatave, organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve, shoqëri civile, institucioneve analoge që operojnë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore gjatë 8 mujorit të vitit 2023 ka realizuar buxhetin në vlerën 127.681 mijë lekë dhe të shprehur në përqindje 60%.

Bashkëlidhur do të gjeni tabelat shoqëruese të raportit të monitorimit për 8-mujorin e vitit 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTOR

Eljo MUÇAJ